



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

Drejtoria e Integritimit dhe Projekteve

PROCEDURAT E REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË  
TË STUDIMEVE NË UNIVERSITETET FRANCEZE,  
VITI AKADEMIK 2016-2017

Në kuadrin e Bashkëpunimit Kulturor, Ambasada e Republikës së Francës në Tiranë njofton se ka filluar fushata e para regjistrimit 2016-2017 për kandidatët e huaj në ciklin e parë të studimeve (universitete dhe shkollë arkitekture) në Francë. Materialet e aplikimit për pranimin paraprak mund të tërhiqen pranë zyrave të Shërbimit të Bashkëpunimit dhe Veprimt Kulturor të kësaj Ambasadë, duke filluar nga data deri **02 dhjetor 2015**, çdo ditë, nga e hëna në të enjte, ora 14:00-17:00. Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dosjet e plotësuara në Ambasadë duke filluar nga data **16 dhjetor 2015** deri në **22 janar 2016** që është dhe afati i fundit për aplikim (nga e hëna deri të enjten, midis orës 14:30 dhe 16:30).

**Procedura e aplikimit:**

Mbas dorëzimit të dokumentacionit, aplikantët duhet të provojnë se kanë nivelin B2 nëpërmjet DELF-it ose TCF DAP. Lidhur me kete kriter, kandidatët do t'i nënshtrohen një provimi lidhur me njohjen e gjuhës frënge (TCF), i cili do të organizohet në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës në datën **11 shkurt 2016**, nga ora **9:00-13:00**. Ky provim është i detyrueshëm për të gjithë aplikantët, me përjashtim të nxënësve të seksioneve dygjuhëshe dhe nxënësve që kanë nivelin DELF B2 dhe DALF C. Në momentin e dorëzimit të dosjes së regjistrimit, kandidati që do të kalojë testin TCF DAP duhet të paguajë 68 €.

Për më tepër informacion mbi procedurën e regjistrimit paraprak (e cila realizohet në gjuhën frënge), kandidatët shqiptarë duhet t'i referohen adresave online në vijim:

<http://www.ambafrance-al.org/Procedures-d-inscription-en-1er-cycle-universitaire-en-France-pour-I-anee-2016;>

[http://www.enseignementsup-recherche.gouv.fr/pid24665-cid24144/-dossier-blanc-demande-prealable-a-une-inscription-en-premier-cycle.html;](http://www.enseignementsup-recherche.gouv.fr/pid24665-cid24144/-dossier-blanc-demande-prealable-a-une-inscription-en-premier-cycle.html)

<http://www.archi.fr/ECOLES/>

**DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE**